



UNIVERSITETI SHQETËROR I TETOVËS

STATE UNIVERSITY OF TETOVA - ДРЖАВЕН УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО

SUT Rectorate - Ilinden nn, 1200 Tetovo, Macedonia

Tel: +389 44 356 500; Fax: +389 44 334 222, email: international@unite.edu.mk

Në bazë të nenit 108 dhe nenit 110 të Ligjit për Arsimin Sipëror ("Fletorja zyrtare" e R. Maqedonisë, nr. 35/2008) dhe të Rregullores për kriteret e regjistrimit në studime deridiplomike në Universitetin Shtetëror të Tetovës, Rektorati i Universitetit Shtetëror i Tetovës shpall:

K O N K U R S

Për transferimin dhe regjistrimin e studentëve në fakultete dhe njësitë akademike të USHT-së për vitin akademik 2010/2011

Tetovë, Janar 2011

I. Transferimi në USHT bëhet në fakultete dhe njësitë akademike ekzistuese:

1	Fakulteti i Shkencave Matematikore Natyrore	7	Fakulteti i Shkencave të Zbatuara
2	Instituti i Ekologjisë	8	Fakulteti Juridik
3	Fakulteti Filozofik	9	Fakulteti Ekonomik
4	Fakulteti Filologjik	10	Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit
5	Fakulteti i Arteve	11	Fakulteti i Shkencave Mjekësore
6	Fakulteti i Kulturës Fizike	12	Fakulteti i Administratës së Biznesit

II. Kushtet e transferimit të studentëve në USHT:

A. Studenti me status të studentit të USHT-së:

1. Të drejtë transferimi brenda njërive akademike të USHT-së kanë të gjithë studentët që kanë index të USHT-së.

B. Studentë nga jashtë:

1. Të drejtë transferimi nga institucionet tjera të arsimit sipëror në njësitë akademike të USHT-së kanë të gjithë studentët që kanë regjistruar dhe të përfunduar së paku një vit akademik nga Universiteti (ose kanë diplomuar) i cili vjen kandidati,
2. Studenti mund të transferohet në fakultetin dhe programin e njëjtë studimor ose në drejtime të ngjashme me fakultetet dhe programet studimore të USHT-së. Ngjashmërinë e programeve studimore e përcakton fakulteti.

C. Në Universitet mund të regjistrohen edhe kandidatët që kanë kryer *shkollën e lartë ose të ngjashme*.

1. Regjistrimi i tyre bëhet në bazë të ngjashmërisë së provimeve të dhëna dhe programeve studimore të shkollimit paraprak.

Ç. Kandidatët që transferohen në USHT regjistrohen me vetëfinancim në studime.

III. Afatet e paraqitjes për transferimin dhe regjistrimin e studentëve.

REALIZIMI I KONKURSIT PËR TRANSFER DHE REGJISTRIM TË STUDENTËVE - 2010/11	Afati për transferim dhe regjistrim
Paraqitja e kandidatëve	11-28 Janar 2011
Shpallja e vendimit për pranim të kandidatëve	4 Shkurt 2011
Regjistrimi i kandidatëve	7-11 Shkurt 2011

IV. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- ✚ *Fletëparaqitja* për aplikim (e cila mund të merret në sportelet e njërive akademike të USHT-së),
- ✚ *Çertifikata e notave dhe indexi* nga Universiteti amë;
- ✚ *CV (biografi e shkurtër) në formë ese;*
- ✚ *Dëftesat origjinale* të të gjitha klasave (ose të verifikuara në noter) dhe *Diplomën e shkollës* së mesme të kryer;
- ✚ *Certifikatën e lindjes* dhe dëshmi për *nënshtetësi të R.M.*-së (çertifikatë ose aktvendim);
- ✚ *Vërtetim për pagesën e 1000 denarëve* për harxhime administrative paguar në xhironlogarinë e USHT-së: 160016005478810, deponent Banka Popullore e Maqedonisë, llogaria 10000000063095, thirrur në numrin 723019, programi 43.

V. Dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim:

Kandidatët e pranuar për regjistrim duhet të paraqesin:

1. Fletëparaqitje për regjistrim (fletëparaqitjet merren në shërbimin për çështje studentore të fakultetit në të cilin studenti regjistrohet)
2. Tri fotografi (*dy* fotografi 6 x 9 dhe *një* – 4 x 5 c. m.)
3. Vërtetim për pagesën e mjeteve:
 - **1200 denarë**, në xhiro-llogarinë e Universitetit: 160016005478810, deponent Banka Popullore e RM-së, llogaria 10000000063095, thirrje në numrin 723019, programi 43, në emër të dhënies së Indexit.
 - **100 denarë** në xhiro-llogarinë e Universitetit: 160016005478810, deponent Banka Popullore e RM-së, llogaria 10000000063095, thirrje në numër 723019, programi 43, në emër të Unionit të studentëve në Universitetin Shtetërorë të Tetovës.
 - **750 denarë**, në xhiro-llogarinë e Universitetit: 160016005478810, deponent Banka Popullore e RM-së, llogaria 10000000063095, thirrje në numër 723019, programi 43, në emër të veprimtarive informative, sportive, kulturore të studentëve të Universitetit.
 - **Pagesa e mjeteve për semestër** (në të cilin është bërë transferimi), në xhiro-llogarinë e Universitetit: 160016005478810, deponent Banka Popullore e RM-së, llogaria 10000000063095, thirrje në numër 723019, programi 43.

Të gjithë kandidatët dokumentet e tyre për aplikim dhe regjistrim duhet t'i dorëzojnë në Fakultetin përkatës, Programin të USHT-së.

Konkursi është i shpallur edhe në web faqen e universitetit: <http://www.unite.edu.mk/>